



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1503 / 5 Prot

Tiranë, më 18.10.2021

VENDIM

Nr. 47, datë 18.10.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Ne mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z.] ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1503 Prot., datë 13.09.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet kërkesës datë 27.07.2021, depozituar në adresën elektronike info@sushefqetndroqi.gov.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. Numrin e pacienteve të shtruar dhe trajtuar në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” me Covid 19 për vitet 2019/2020 dhe periudhën Janar - Qershor 2021;
2. Numrin e pacientëve të infektuar me Covid 19 që kanë pësuar nevojë për oksigjen medikal në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” për vitet 2019/2020 dhe periudhën Janar-Qershor 2021;
3. Numrin e operacioneve të kryera në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” për vitet 2019/2020 dhe periudhën Janar- Qershor 2021;
4. Nje kopje të procedurave të tenderave të zhvilluar nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” për furnizimin me oksigjen medikal për vitet 2019/2020 dhe periudhën Janar- Qershor 2021;

5. *Një kopje të kontratave të lidhura nga Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" për furnizimin me oksigjen medical për vitet 2019/2020 dhe periudhën Janar - Qershor 2021.*

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI"). Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 1503/1 prot., datë 15.09.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, brenda datës 21.09.2021.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 31/9 Prot., datë 21.09.2021 ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion informacion lidhur me pikat 1, 2, 3 dhe 4 të kërkesës si dhe duke sqaruar ndër të tjera se: "*..Në zbatim të Rregullave të Prokurimit Publik, procesverbalet e mbajtura janë personale dhe konfidenciale pasi aty janë firmat dhe emrat e anetarëve të komisioneve dhe dhenia e ketyre dokumentacioneve perben shkelje të rregullave të ruajtjes së konfidencialitetit. Njëkohësisht, DST-Dokumente Standarte të Tenderit ashtu si të gjitha procedurat janë transparente dhe shumë lehte të verifikueshme në faqen zyrtare www.app.gov.al. Për këtë arsye, kemi vënë edhe referencat per secilën procedurë, për t'i shqyrtuar mënyrën e zhvillimit të tyre.*"

Gjithashtu, nëpërmjet emailit të datës 28.09.2021, Autoriteti Publik ka sqaruar se: "*Për kontratat e lidhura kemi vënë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshem, fondin limit, vlerat dhe datat e seciles kontratë te lidhur për secilen procedurë. Keto informacione i posedoni edhe në Regjistrat elektronike të APP-së dhe në Buletinet e Publikuara*"

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesi pretendon se nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar në pikën 5 të kërkesës dhe si rrjedhojë me emailin e regjistruar me nr. 1503/4 Prot., datë 11.10.2021 ka vijuar ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, konkretisht pika 5 e kërkesës për informacion datë 27.07.2021.

Nga shqyrtimi i çështjes, Komisioneri konstaton se, dokumentacioni i kërkuar ka të bëjë me një procedurë prokurimi publik, e cila i nënshtrohet dispozitave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (ligji i zbatueshëm në atë kohë), si dhe ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Neni 25 i ligjit nr. 9643, datë 30.11.2006 “Për prokurimin publik”; i ndryshuar, përcakton kufizime mbi autoritetin publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare, si dhe informacionet konfidenciale të ofertave. Kufizim, ky i parashikuar edhe në nenin 16 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Siç mund të vërehet nga dispozita e mësipërme, konfidencialiteti lidhet me aspekte teknike, sekrete tregtare dhe të dhëna të tjera konfidenciale me të cilat Autoriteti Publik është njohur ose i janë vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë gjatë procesit të prokurimit publik. Pra, në këtë përcaktim nuk përfshihen kontratat për punë, blerje produkte apo shërbime publike, procesverbalet, raportet teknike që mund të mbajë autoriteti publik gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit publik, e cila edhe nga vetë emri është vetëshpjeguese për natyrën e saj.

Për më tepër, theksojmë se, një pjesë e informacionit të kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni, që duhet të bëhet publik pa kërkesë. Çdo autoritet publik, bazuar në pikën e) të nenit 7 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; duhet të ketë publik në programin e transparencës *informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:*

- i. listën e kontratave të lidhura;
- ii. shumën e kontraktuar;
- iii. palet kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e informacionit nuk rezulton i bazuar në ligj.

Në çdo rast, edhe nëse do të kishte aspekte konfidenciale, në frymën e nenit 17 pika 6 e LDI, sipas të cilit “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të dokumenteve, të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tyre.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar në pikën 5 të kërkesës për informacion përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, “autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga z. ,
nr. 1503 Prot., datë 13.09.2021, ndaj Autoritetit Publik “Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 27.07.2021, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht:
- Një kopje të kontratave të lidhura nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” për furnizimin me oksigjen medical për vitet 2019/2020 dhe periudhën Janar - Qershor 2021, brenda datës 15.10.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 18.10.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi